

Fakte kryesore për HIV dhe AIDS

- HIV vazhdon të mbetet një problem i madh i Shëndetit Publik në nivel global, duke marrë më shumë se 35 milionë jetë njerëzish deri tani. Në vitin 2016, në nivel global 1 milion njerëz vdiqën nga shkaqet e lidhura me HIV-in.
- Në fund të vitit 2016, globalisht pati përafërsisht 36.7 milionë njerëz që jetonin me HIV, ku 1.8 milionë prej tyre u infektuan vetëm në vitin 2016.
- 54% e të rriturve dhe 43% e fëmijëve që jetojnë aktualisht me HIV marrin terapinë gjithëpërfshirëse antiretroviroale (ART).
- Afrika Sub-Sahariane është rajoni më i prekur me 25.6 milionë persona me HIV.
- Infekzioni HIV shpesh diagnostikohet nëpërmjet testeve të shpejta diagnostike, që zbulojnë praninë ose mungesën e antitrupave HIV. Shumica e këtyre testeve japid rezultate brenda ditës, gjë që është thelbësore për vendosjen e diagnozës në të njëjtën ditë, si dhe për trajtimin dhe kujdesin e hershëm.
- Grupet që janë në rrezik të lartë për t'u infektuar me HIV (popullatat kyçë) përfshijnë: burrat që kanë marrëdhënie seksuale me burra, ata që injektojnë droga, të burgosurit dhe personat që jetojnë në mqedise të tjera të myllura, punonjësit e seksit dhe klientët e tyre, si dhe transgjinorët. Popullatat kyçë shpesh kanë sjellje që rrisin vulnerabilitetin ndaj HIV-it dhe zvogëlojnë aksesin në programet e testimit e trajtimit.
- Në vitin 2015, 44% e rasteve të reja ndodhën pikërisht në këto populata e partnerët e tyre seksualë.
- Për infekzionin HIV nuk ka shërim. Megjithatë, medikamentet efektive antiretroviroale (ARV) ndihmojnë për të kontrolluar virusin dhe për të parandaluar transmetimin në mënyrë që, njerëzit me HIV si dhe ata në rrezik të madh për t'u infektuar të mund të gjelqinë jetë të shëndetshme dhe produktive.
- Aktualisht vetëm 70% e personave me HIV e dinë statusin e tyre.
- Deri në fund të vitit 2016, globalisht 19.5 milionë njerëz që jetojnë me HIV kanë marrë terapi antiretroviroale.
- Nga viti 2000 deri në vitin 2015, infekzionet e reja me HIV kanë rënë me 39%, dhe numri i vdekjeve nga AIDS ka rënë me 1/3. Rreth 13.1 milionë jetë janë shpëtar nga marrja e terapisë antiretroviroale në të njëjtën kohë me vendosjen e diagnozës.

Çfarë është HIV?

HIV është virusi i cili prek dhe dobëson sistemin imunitar të organizmit të njeriut duke e lënë atë të pambrojtur nga infekzionet dhe nga disa lloje kancerit.

Çfarë është AIDS?

Faza më e avancuar e infekzionit HIV është **AIDS**, i cili mund të zgjasë nga 2 deri në 15 vjet për t'u zhvilluar, në varësi të individit. AIDS është përcaktuar si zhvillimi i llojeve të ndryshme të kancerit, infeksioneve apo manifestimeve të tjera të rënda klinike. HIV nuk është sinonim i

AIDS. Një person i infektuar me virusin HIV, jo domosdoshmërisht është i sëmurë me AIDS; ai mund të jetë i infektuar me virusin HIV, por mund të mos jetë i sëmurë me AIDS.

Si transmetohet HIV?

Transmetimi i HIV-it mund të ndodhë nëpërmjet shkëmbimit të një shumëlojshmërie lëngjesh të infektuara të trupit të njeriut si gjaku, qumështi i gjirit, sperma dhe sekrecionet vaginale.

Disa nga sjelljet dhe kushtet që vënë individët në rrezik më të madh për t'u infektuar me HIV përfshijnë:

- Marrëdhëniet seksuale vaginale ose anale të pambrojtura.
- Pasja e një infekzioni tjetër seksualisht të transmetueshëm si sifilizi, herpesi, klamidia, gonorrea dhe vaginosa bakterore.
- Shkëmbimi i mjeteve të kontaminuara si gjilpëra, shiringa e pajisje të tjera gjatë injektimit të drogës.
- Marrja e injeksioneve apo transfuzioneve të gjakut të pasigurta, transplant i organeve, si dhe procedurat mjekësore me instrumente të mprehta të kontaminuara.
- Shpimet aksidentale me gjilpërë (përfshirë dëmtimet e stafit shëndetësor).

Individët nuk mund të infektohen me HIV nëpërmjet kontaktit të zakonshëm të përditshëm si puthjet, përqafimet, takimi i duarve ose ndarja e objekteve personale, ushqimit, ujit etj.

Cilat janë shenjat e AIDS?

Shenjat ndryshojnë në varësi të fazës së infeksionit. Shumë prej njerëzve që jetojnë me HIV nuk janë në dijeni të gjendjes së tyre HIV pozitiv deri në fazat e mëvonshme. Javët e para pas infeksionit fillestar, këta persona mund të mos kenë asnjë shenjë ose mund të shfaqin shenja të ngjashme me gripin si: ethe, dhimbje koke, skuqje apo dhimbje të fytit. Me dobësimin progresiv të sistemit imunitar, infekzioni përparon dhe një person mund të zhvillojë edhe shenja të tjera të cilat ndryshojnë në varësi të fazës së infeksionit si: fryrje e nyjeve limfatike, humbje e madhe në peshë, ethe/temperaturë, diarre e vazhdueshme, kollë. Pa trajtim mund të shfaqen edhe shenja të tjera sipas llojit të infeksioneve të ndryshme oportuniste.

Si diagnostikohet HIV dhe AIDS?

Sot janë në dispozicion teste të ndryshme që zbulojnë praninë ose mungesën e antitrupave të HIV-it. Ritestimi i individëve që diagnostikohen me HIV është praktikë e mirë për të përjashtuar çdo gabim të mundshëm testimi apo raportimi. Të gjitha shërbimet e testimit të HIV-it duhet të ndjekin parimet e rekomanduara nga OBSH-ja: miratim i informuar, konfidencialitet, këshillim, rezultate të sakta të testimit dhe lidhje me kujdesin, trajtimin dhe shërbimet e tjera.

Parandalimi i HIV-it?

Individët mund të zgjedhjnë rrezikun e infektimit me HIV duke kufizuar ekspozimin ndaj faktorëve të rrezikut.

Mënyrat kryesore për parandalimin e HIV-it, të cilat shpesh përdoren në kombinim me njëratjetrën janë:

- Përdorimi korrekt i prezervativit
- Testimi dhe këshillimi për HIV dhe IST të tjera.
- Rrethprerja mashkullore mjekësore vullnetare (syneti)
- Përdorimi i terapisë antiretrovirale (ARV) për parandalim.
- Reduktimi i dëmit për përdoruesit e drogave intravenoze.
- Eliminimi i transmetimit të HIV-it nga nëna tek fëmija.
- Trajtimi i AIDS.

Sot infekzioni HIV mund të kontrollohet nëpërmjet përdorimit të terapisë antiretrovirale të kombinuar, e cila përbëhet nga 3 ose më shumë barna antiretrovirale. Barnat antiretrovirale nuk kurojnë infeksionin HIV, por kontrollojnë shumimin e virusit brenda trupit të një personi dhe i mundësojnë sistemit imunitar të individit të fuqizojë kapacitetin për të luftuar infeksionet.

Mjekimi me ARV zgjat jetën e të sëmurëve dhe rrit cilësinë e saj, duke e shndërruar AIDS-in në një sëmundje kronike.